

42/20

Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Deçan  
Departamenti i përgjithshëm

Në mbështetje të Nenit 252 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, tash e tutje referuar si **Ligji pëtë Procedurën Kontestimore**, në lidhshmëri me Nenin 4, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 02/L65 Civil kundër Shpifjes dhe Fjetjes, tash e tutje referuar si **Ligji kundër Shpifjes dhe Fjetjes**, Kelkos Energy Sh.P.K., me numër unik identifikues 810796005 dhe adresë në Rrugë Deme Ali Pozhazhi 41, 51000 Deçan, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuara, Arjanit Koci, avokat, me adresë në Rrugën Robert Doll, Nr. 34, 10000 Prishtinë, me respekt, parashiron këtë:

---

**PADI PËR KOMPENSIM DËMI PËR SHKAK TË SHPIFJES**

---

Paditës:

**KELKOS ENERGY Sh.P.K.**, me numër unik identifikues 810796005 dhe adresë në Rrugë Deme Ali Pozhazhi 41, 51000 Deçan, duke vepruar nëpërmjet përfqaqësuesve me autorizim, Arjanit Koci, avokat, tutje referuar si "Paditësi"

I Paditur:

**Adriatik Gacaferi**, tash e tutje referuar si "i Padituri"

Vlera e Kontestit:

**10.000,00 €**

31 janar 2020, Prishtinë

## 1. Konstatimi i Shpifjes

- 1.1. Sipas një statusi të postuar me datë 1 nëntor 2019 në median sociale Facebook, i Padituri thikson se: “*[Hidrocentrali Lumbardhi 2 në Grykën e Deçanit, sot rrëb orës 14:30 duke futur 100% të ujut në gjypa edhe pse në marrëveshjen që ka me Ministrinë e Mjedisit është i obliguar që të pakto 30% të ujut ta të gjithmonë në shtratin e lumit. Sikur të kishte pasur një gjykati që do i mbrojtë kafshët e egra dhe peshqit, Kelkos Energy (pronari e HEC) do ishte denuar për genocid naj kafshëve dhe peshqiv*”. Kjo deklarata është plotësisht e pavërtetë. Deklarata të tilla të pavërteta të cilat cenojnë integritetin dhe reputacionin e individiave sankzionohen më anë të dispozitave ligjore.

### Prova Nr. 1: Postimi në Facebook.

- 1.2. Kështu, sipas Nenit 3, pika a) të Ligjit për Shpifje dhe Fyerje: “*[r]ajhpifa nënkuption publikimin e një fakti ose deklaratës të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur t'a dijë se fakti është e pavërtetë, kuptimi i të cilës dëmton reputacionin e një personi tjeter*”. Sipas ketij perkufizimi, elementet kyçe nga të cilat përbëhet një akt i shpifjes – e të cilat janë manifestuar në veprimet e publikuesit – janë plotësuat, duke filluar nga fakti se individi ka publikuar një fakt të pavërtetë; përfundimisht, qenë i vëtëdijshtëm ose është dashur të jetë i vëtëdijshtëm se deklarata është e pavërtetë; ngase ka mundur ta vëtifikohet me lehtësi vërtetësinë e deklaratës së tij, deklarata e tillë ka kulmuar me dëmtimin e reputacionit të Kelkos Energy si një ndërmarrje e respektuar në shoqërinë kosovare dhe një investitor i madh në energjinë e gjelbër në Kosovë.
- 1.3. Në bazë të deklaratës së tij, i Padituri pretendon se Paditësi është duke futur të gjithë ujin e lumit në gjypa – që supozohet të jetë në shtratin e lumit, në kundërshtim me marrëveshjen e pretenduar të cilën Paditësi e ka lidhur me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinot – e cila, sipas pretendimeve të të Paditurit, e obligon që 30% e ujit të mbetet gjithmonë në rrjedhën e lumit. I Padituri e bazon këtë pretendim kryekëput mbi bazën e një fotografie, e cila nuk vërteton asnjë nga pretendimet e të Paditurit.
- 1.4. Në të kundërtën, Paditësi mund të dëshmojë se në ditën kur i Padituri postoi fotografinë dhe përditësoi statusin në median sociale Facebook, **Hidrocentrali Lumbardhi II** ka qenë jashtë funksionit. Ky fakt e bën të pamundur që ndonjë sasi e ujit të jetë futur në gypat e Paditësit. Përkundrazi, turbinat e HEC Lumbardhi II e kanë lënë 100% të ujut të lumit Lumbardh të paprekur.

**Prova Nr. 2:** Raporti i Prodhimit të KelKos Energy dërguar në KOSTT për HEC Lumbardhi II për periudhën Prill 2019, ku vlera matëse e energjisë në ditën e fundit të prodhimit më 15 Prill 2019 (shih faqe 9) është 334.578 kWh.

**Prova Nr. 3:** Fotografia e njehsorit matës të energjisë të HEC Lumbardhi II nga 2 nëntori 2019, disa ditë

pas publikimit të deklaratës kontestuese të të Paditurit, duke treguar të njejtën vlerë matëse të enërgjisë si në prill 2019, respektivisht 334.578 kwh.

**Prova Nr. 4:** Artikulli "Kush po e deshiron ikjen e investitorëve të huaj" i publikuar në internet në "rtklive.com" më datë 3 nëntor 2019, i cili raporton për ketë çështje dhe paraqet Provën nr. 3;

**Prova Nr. 5:** Vendimi V\_1121\_2019 i Zyres së Rregulatorit për Energi (ZRRE) i datës 28 mars 2019, lidhur me mbylljen e përkohshme të HEC Lombardhi II.

**Prova Nr. 6:** Letra zyrtare e KOSTI-it drejtuar Kelkos Energy më datë 15 prill 2019, ku kerkohet nga Kelkos Energy që të mbille përkohësisht HEC Lombardhi II.

**Prova Nr. 7:** Email konfirmimi i KelKos Energy drejtuar KOSTI-it më datë 16 prill 2019, lidhut me mbylljen e HEC Lombardhi II.

**Prova Nr. 8:** Letër infotmuese e KelKos Energy drejtuar KOSTI-it më datë 20 nëntor 2019, me të cilën njofton përfillimin e prodhimit të enërgjisë nga HEC Lombardhi.

*Shënim: KOSTI është Operatori i Sistemit, Transmissionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës.*

1.5. Për më tepër, me anë të paragjykimeve slajshmërisht të pabazuara dhe shprehjeve tejet nënçmuese, përmes fjalise: "Njëkunë të kishte pasur një gjykatë që do i mbrontë kafshët e egra dhe peshqit, Kelkos Energy (prosari e HEC) do t'iste dënuar për gjencid saj kafshëve dhe peshqir", i Padituri ka tentuar që të etiketoje Paditësin si kryerës të veprave penale tujedisore – gjë për të cilën nuk është aspak kompetent, duke e bazuar etiketimin e dhënës në faktë të rreme. Shprehjet e rilla e etiketojnë në mënyrë të padrejtë Paditësin si shkelës (ë ligjeve përmbrrojtjen e mjedisit – duke shkaktuar dëm jashtëzakonisht të madh në reputacionin e këtij të fundit). Rrjedhimi është, rëndësia e Paditësit në sektorin e energjisë së gjelbër në Kosovë, ka ndikuar që disa medie dhe portale në internet t'a shpërndajnë postimin e të Paditurit – duke e shtuar kështu intensitetin e përhapjes së dezinformimit.

1.6. Për më tepër, i njëjti postim shpifës në mediat sociale – deri më tanë – është shpërndarë njëqind e trembëdhjetë (113) herë, duke ndikonat që mijëra përdorues të medias sociale Facebook – të vënë në lajthim nga i Padituri – të krijojnë trendimin se Paditësi me të vërtetë është duke shkelur marrëveshjen potenciale të cilën mund ta ketë lidhur me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – dhe në mënyrë indirekte po i kontribuon varfërimit të botës shtazore të cilët jetojnë

në përgjatë lumit Lumbardh. Duke ditur ndikimin e mass mediave si dhe faktin se i Padituri është direkt i involvuar në çështje që kanë të bëjnë më mbrojtjen e mjedisit – demin i shkaktuar në reputacionin e Kelkos Energy si Paditës – me auë të përhapjes së informacioneve të pavërtetë nga i Padituri – është enorm, siç edhe do të elaborohet më poshtë.

**Prova Nr. 9: Postimi dhe shifrat e shpërndaqjeve që ka arritur në momentin e dorëzimit të Padisë**

- 1.7. Edhe nëse i Padituri prerendon se postimi i tij kishte të bëjë më mbrojtjen e interesit të përgjithshëm (general interest), sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, tash e tutje refetoar si “**GjEDNJ**” në rastin Cicad k. Switzerland, paragrafi 54, 55, 56: “*„[p]oja marrë parasysh faktin se Palet kanë marrë pjesë në një debat në dobi të interesit të përgjithshëm, Gjykata konsideroi se deklaratat e të Paditurit përbënë shpifje, megjë përendinat ishin ag serioze sa për të fajësuar Paditësin për një krim nën ligjin zviceran. Ky artikull mund të kishte paoja serioze për jetën personale dhe profesionale të Paditësit andaj edhe shpërblimi i akorduar për dëmin e shkaktuar Paditësisë është i justifikuar“.*
- 1.8. Vis-a-vis, edhe në rastin tonë, në bazë të preteudimeve të të Paditurit – Paditësi ka mundur që të implikohet padrejtësiaht dhe në mënyrë të pajustifikueshme në probleme serioze ligjore – të cilat kanë mundur të rezultojnë në bindjen e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë se Paditësi është duke shkelur marrëveshjen – e poshtu edhe të akuzohet padrejtësiaht për kryerje të ndonjë vepre penale nga Kapitulli XXVII i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

## **2. Kompensimi i dëmit material dhe jomaterial**

- 2.1. Deklaratat e të Paditurit – siç u theksua edhe më lartë – kanë rezultuar në dëmtimin e reputacionit të Paditësit, si një prodhues i sulsesshëm i energjisë së gjelbër dhe kompani e cila i respekton ligjet e Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht, në bazë të Nenit 187 të të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, tash e tutje referuat si **Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve**: “[gjykata i jep shpërblim të drejtë në të bulla personit juridik për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë, pavarësisht dëmshpërbimit të dëmit material [...]” Marrë parasysh se Paditësi gjithmonë ka pasur një emër të mirë, ulja e reputacionit dhe statusit të respektuar në shoqëri, mund të ketë pasoja të rënda për Paditësin – të cilat duhet domosdoshmërisht të sankzionohen.
- 2.2. Duke marrë parasysh faktin se profili i Paditësit është tejer i lartë, kompensimi i dëmit që mund t'i atribuohet, vështrirë se do të kompensonte dëmin real të shkaktuar në reputacionin e Paditësit. Megjithatë, shpërblimi i akorduar mund të shërbejë si një vlerë satisfaktore, apo parandalim i përhapjes së faktave të pavërtetë në të ardhmen. Paditësi zotohet që në rast se aprovohet padia dbe kërkesëpadia e është nga gjykata, shuma e dëmshpërbimit të aprovuar nga gjykata do të dhurohet për ndonjë iniciative shoqërore. Ky shpërblim gjithashtu do të konsiderohet si një masë e përgjithshme dbe parandaluese, pasiakuza të tillë të pavërteta po shfaqin një praktikë/zakon, të pëthapur por rrallë të sanksionuar, të medieve të internetit në Kosovë, payarësisht natyrës së tij të pavërtetë dbe shpifëse.

- 2.3. Kësisoj, në bazë të fakteve të paraqitura dhe dispozitave, Paditësi propozon që Gjykata Themelore, Departamenti i Përgjithshëm, pas shqyrtimit të padisë dhe administrimit të provave, që të nxjerrë këtë:


### AKTGJYKIM

- I. **APROVOHET** në tërësi faktikisht dhe juridikisht Padia e Paditësit "Kelkos Energy" Sh.P.K., me mbi numër unik identifikues 810796005 dhe adresë në Rruga Deme Ali Pozhari 41, 51000 Deçan, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar, Arianit Koci, avokat;
- II. **DETYROHET** i Padituri Adriatik Gacaferi, që nën kërcënimin e përbartimit të dhunshëm t'i paguajë Paditësit, në emër të kompensimit për dëmin jomaterial, shumën prej 10.000,00 €, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi.
- III. I padituri Adriatik Gacaferi është i OBLIGUAR që të bëjë tërheqjen e lajmët shpisës dhe të publikoje një deklaratë mobuese të lajmët shpisës në llogarinë e tij në Facebook, deklaratë e cila duhet të jetë e qasshme për lexuesit për një periudhë prej dy mbëdhjetë (12) muajve.

Me respekt,

**Për dhe në emër të Paditësit dhe Propozuesit,**

Arianit Koci, avokat

  
Arianit Koci  
Avokat - Attorney at Law  
ARIANIT KOÇI  
Tel. 044 588 555  
koci@kpclvokshi.com  
Prishtina